| *Nr. Rendor* | *Data e kërkesës* | *Objekti I kërkesës* | *Data e përgjigjes* | *Përgjigje* | *Mënyra e përfundimit të kërkesës* | *Tarifa* |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 03.02.2025 | Pranë Ministrisë së Drejtësisë është paraqitur në rrugë elektronike kërkesa për informacion nga z. Elvis Myrta, administruar pranë nesh me nr. 14 regj, në kuadër të së drejtës për informim në bazë të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar. Për informacionin e disponuar nga Ministria e Drejtësisë, kërkuesit i është kthyer përgjigje sipas materialit bashkëlidhur. Në kushtet kur Ministria e Drejtësisë nuk disponon pjesën tjetër të informacionit të kërkuar, në zbatim të nenit 10, pika 2, shkronja "d" dhe nenit 12, pika 2, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", lutem ndjekjen kërkesës dhe kthimin e përgjigjes kërkuesit. | 06.02.2025 | Ne vijim te kerkeses suaj per informacion drejtuar Ministrise se Drejtesise e percjelle edhe ne Arkivin Shteteror te Sistemit Gjyqesor per dhenie informacioni, ju bejme me dije se ASHSGJ ne realizimin e misionit dhe detyrave funksionale qe ushton, nuk ka bashkëpunime me projekte që mbështeten nga SHBA. | E plotë | Jo |
| 2 | 11.02.2025 | Pranë Ministrisë së Drejtësisë është paraqitur në rrugë elektronike kërkesa për informacion nga znj. Vivian Mancellari administruar pranë nesh me nr. 135 regj, në kuadër të së drejtës për informim në bazë të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar.<br><br>Në kushtet kur Ministria e Drejtësisë nuk disponon informacionin e kërkuar lidhur me pyetjet 6, 8 - 17, 21-25, 26 dhe 28-37, në zbatim të nenit 10, pika 2, shkronja "d" dhe nenit 12, pika 2, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", lutem ndjekjen kërkesës dhe kthimin e përgjigjes kërkuesit. | 14.02.2025 | Në përgjigje të kërkesës për informacion nga Znj. Mancellari, ju informojmë si më poshtë vijon:Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR) është person juridik publik, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, që ka filluar veprimtarinë e saj në muajin Mars të vitit 2021. Funksionimi dhe organizimi i saj bazohen në parashikimet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, si dhe vendimit nr. 314, datë 15.05.2019, të Këshillit të ministrave "Për organizimin, funksionimin, si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, të ndryshuar. Misioni kryesor i Qendrës është kryerja e aktiviteteve rehabilituese dhe riintegruese përmes mbikëqyrjes dhe mbrojtjes së të miturve/të rinjve pas vuajtjes së dënimit dhe fusha e përgjegjësisë së saj është parandalimi i krimeve të të miturve dhe të rinjve. Misioni do të përmbushet edhe duke nxitur zhvillimin pozitiv përmes zbatimit të programeve të rehabilitimit dhe riintegrimit.<br>Për sa i përket pyetjeve që ju referoni në-emailin tuaj, po ju rendisim përgjigjet përkatëse për aq sa i takon fushës së përgjegjësisë së QPKMR: 6) Kush janë aktorët kryesorë në investim për masat alternative përveç Ministrisë së Drejtësisë? Masat alternative nuk janë në kompetencë të QPKMR 8) Janë ndërtuar dhoma të specializuara për intervistimin e të miturve në gjithë vendin? Ku në specifikë? Sa ka qenë kosto për dhomë të specializuar? Jashtë kompetencës së QPKMR. 9) Fondet për Qendrat multifunksionale dhe qendrat e parandalimit i alokohen Bashkive për menaxhimin e shpërndarjen e tyre, apo menaxhohen nga Ministria e Drejtësisë dhe alokohen sipas nevojave? Fondet për Qendrën e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve alokohen nga Ministria e Drejtësisë sipas nevojave. Pyetjet 10-17, si dhe 21-25 janë jashtë fushës së përgjegjësisë së QPKMR për t'u përgjigjur. 26) Sa janë të miturit që kanë ndjekur programet e rehabilitimit pas përfundimit të dënimit dhe sa janë të mitur që janë rikthyer në sistemin e drejtësisë për vit nga 2018 deri më 2024? Sipas të dhënave që QPKMR disponon që prej vitit 2021 (vitit të krijimit të saj), rezulton si vijon: Viti 2021-2022 Recidivist 3 Marrë shërbime 21, Viti 2022-2023 Recidivist 4 Marrë shërbime 13, Viti 2023-2024 Recidivist 5 Marrë shërbime 32. 28) A ekziston një databazë kombëtare për monitorimin e rasteve të të miturve në konflikt me ligjin? E vetmja "databazë" ku QPKMR ka akses është Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur , i ngritur në bazë dhe për zbatim të parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, si dhe VKM nr. 149, dt. 20.03.2019, "Për krijimin, organizimin, funksionimin, karakteristikate përdorimit e aksesimit, të dhënat parësore e dytësore dhe dhënësin e informacionit të Sistemit të Integruar të të dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur", të ndryshuar. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur përmban të dhëna elektronike të përditësuara mbi çdo fazë të procedimit penal, përfshirë edhe ekzekutimin e vendimit penal, ku përfshihen të miturit në konflikt me ligjin penal, të mitur viktima dhe dëshmitarë të veprave penale. Sistemi popullohet me të dhëna nga disa institucione, si: Policia e Shtetit, Prokuroria, Gjykatat, institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, ku ndodhen të miturit e dënuar ose të paraburgosur, Shërbimi i Provës, etj. Nga ana tjetër, QPKMR disponon një databazë të sajën për çdo rast që trajton, të dhënat e së cilës janë konfidenciale bazuar në parashikimet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, ku garantimit i parimit të konfidencialitetit është thelbësor për sa kohë që kemi të bëjmë me të mitur. Databaza përditësohet sa herë paraqitet një rast i ri për trajtim. 29) Kur është krijuar ajo dhe sa shpesh përditësohet? Nëse i referoni databazës si më sipër, është krijuar në vitin 2021, pra qysh prej krijimit të Qendrës dhe përditësohet sa herë paraqiten raste të reja për trajtim. 30) Kush është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe përditësimin e saj? Sërish, nëse i referohemi Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, administrohet nga Ministria e Drejtësisë dhe hostohet në serverët e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit AKSHI. 31) Si sigurohet shkëmbimi i informacionit mes institucioneve që përdorin databazën? Shih VKM nr. 149, dt. 20.03.2019, "Për krijimin, organizimin, funksionimin, karakteristikate përdorimit e aksesimit, të dhënat parësore e dytësore dhe dhënësin e informacionit të Sistemit të Integruar të të dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur", të ndryshuar, e cila përmban informacion të detajuar mbi përdorimin dhe funksionimin e Sistemit. Pyetjet 32-37 janë jashtë kompetencës së QPKMR për t'u përgjigjur.<br>Për më shumë informacion mbi drejtësinë penale për të mitur, veprimtarinë e QPKMR, si dhe aktivitetet që Qendra zhvillon, mund të vizitoni faqen zyrtare https://qpkmr.gov.al/ , si dhe rrjetet tona sociale. | E plotë | Jo |
| 3 | 12.03.2025 | Jam Neta Fero, gazetare e POLITIKO.AL. Ju kontaktoj pasi më duhet informacion se sa ka qenë numri i të rinjëve gjatë vitit 2024 që janë rehabilituar pranë qendrës tuaj. | 12.03.2025 | Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR) është një institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, i krijuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 314, datë 15.05.2019, "Për organizimin, funksionimin dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve", i ndryshuar. Misioni kryesor i Qendrës është realizimi i veprimtarisë rehabilituese dhe riintegruese, në përputhje me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, përmes mbikëqyrjes dhe mbrojtjes së të miturve dhe të rinjve pas përfundimit të kryerjes së dënimit penal.<br>QPKMR ka si fushë të veprimtarisë së saj parandalimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e të miturve dhe të rinjve pas përfundimit të kryerjes së dënimeve penale, duke promovuar zhvillimin e tyre pozitiv përmes programeve parandaluese, rehabilituese dhe riintegruese.<br>Përsa i përket kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve për vitin 2024, ka trajtuar 32 raste të të miturve në konflikt me ligjin, të liruar nga Instituti i të Miturve Kavajë. | E plotë | Jo |
| 4 | 30.03.2025 | Bazuar në Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit", ju lutem gjeni bashkëngjitur formularin me informacionin e kërkuar prej institucionit tuaj.<br>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetem në dispozicionin tuaj për çdo sqarim të mëtejshëm.<br>1. Cilat janë statistikat e të miturve të përfshirë në krime në secilin nga 5 vitet e fundit sipas grupmoshave dhe veprave penale?<br>2. Sa të mitur është duke trajtuar aktualisht QPKMR-ja?<br>3. Sa të mitur ka trajtuar QPKMR-ja në secilin nga vitet e fundit, që prej nisjes së veprimtarisë, sipas veprave penale që kanë kryer?<br>4. A ekzistojnë dallime të dukshme në përfshirjen e të miturve në krime sipas rajoneve apo komunave?<br>5. Si operon QPKMR-ja për të parandaluar krimet tek të miturit dhe a kanë ndryshuar këto strategji që prej krijimit të qendrës, nëse po, si?<br>6. Cilat janë faktorët kryesorë që kanë ndikuar në ndryshimet statistikore gjatë pesë viteve të fundit dhe çfarë masash rekomandohen për të përmirësuar trendet aktuale?<br>7. Cili është bashkëpunimi juaj me Institutin e të Miturve në Kavajë dhe cilat mendoni se janë elementet që duhen përmirësuar në këtë bashkëpunim, apo tek vetë Instituti për rehabilitimin sa më eficent e të miturve të përfshirë në krime? | 07.04.2025 | Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR) është person juridik publik, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, që ka filluar veprimtarinë e saj në muajin Mars të vitit 2021. Funksionimi dhe organizimi i saj bazohen në parashikimet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, si dhe vendimit nr. 314, datë 15.05.2019, të Këshillit të ministrave "Për organizimin, funksionimin, si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, të ndryshuar. Misioni kryesor i Qendrës është kryerja e aktiviteteve rehabilituese dhe riintegruese përmes mbikëqyrjes dhe mbrojtjes së të miturve/të rinjve pas vuajtjes së dënimit dhe fusha e përgjegjësisë së saj është parandalimi i krimeve të të miturve dhe të rinjve. Për sa i përket pyetjeve që ju referoni në-emailin tuaj, po ju rendisim përgjigjet përkatëse<br>1. Cilat janë statistikat e të miturve të përfshirë në krime në secilin nga 5 vitet e fundit sipas grupmoshave dhe veprave penale? (tabela bashkelidhur)<br>2. Sa të mitur është duke trajtuar aktualisht QPKMR-ja?<br>Për vitin 2025, Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka në trajtim 21 raste të të miturve në konflikt me lihjin të cilët janë liruar nga Instituti i të Miturve Kavajë.<br>3. Sa të mitur ka trajtuar QPKMR-ja në secilin nga vitet e fundit, që prej nisjes së veprimtarisë, sipas veprave penale që kanë kryer? (tabela bashkelidhur<br>4. A ekzistojnë dallime të dukshme në përfshirjen e të miturve në krime sipas rajoneve apo komunave?<br>Bazuar në përcaktimet ligjore, QPKMR punon me të konflikt me ligjit të cilët janë liruar nga Instituti i të miturve Kavajë. Përsa i takon dallimeve sipas rajoneve, kryesisht, vërehet se kriminaliteti i të miturve është më i lartë në qytetet e mëdha dhe zonat urbane me popullsi më të dendur, krahasuar me zonat rurale,<br>5. Si operon QPKMR-ja për të parandaluar krimet tek të miturit dhe a kanë ndryshuar këto strategji që prej krijimit të qendrës, nëse po, si?<br>Për realizimin e veprimtarisë parandaluese QPKMR ka inicuar disa programe si fushata ndërgjegjësimi në shkolla, apo hartimi i materialeve informuese. Zhvillimi I fushatave informuese vjen në zbatim të parashikime ligjore të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, si dhe Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të mitur 2022-2026 dhe ka për qëllim informimin e të miturve në kuadër të njohjes me parimet e drejtësisë penale për të mitur, si dhe programet prarandaluese, rehabilituese dhe Riintegruese që Ministria e Drejtësisë dhe QPKMR harton. Gjithashtu ka për qëllim dhe ndërgjegjësimin e komunitetit që do të presë të miturit pas përfundimit të perudhës së dënimit apo lirimit me kusht.<br>Gjithashtu ka hartuar disa spote në gjuhën e shenjave me natyrë informuese dhe sensibilizuese të publikut mbi rolin e programeve riintegruese dhe dhënien e një mesazhi për të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin që të ndërgjegjësohen për pasojat e veprave penale që ata kryejnë. Këto spote ndërgjegjësuese vinë në përputhje dhe me fushën e veprimtarisë së QPKMR-së, në ushtrimin e veprimtarive parandaluese nëpërmjet aktiviteteve dhe fushatave sensibilizuese me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit për të miturit që do të rikthehen pas periudhës së dënimit, por edhe të rritjes së edukimit publik mbi veprimtaritë kriminale, dënimet penale si dhe shpërndarjen e informacionit mbi zgjidhje konkrete. Të gjitha këto spote janë të publikuara në faqen zyrtare të QPKMR-së.<br>6. Cilat janë faktorët kryesorë që kanë ndikuar në ndryshimet statistikore gjatë pesë viteve të fundit dhe çfarë masash rekomandohen për të përmirësuar trendet aktuale?<br>Gjatë pesë viteve të fundit, është vënë re një rritje e numrit të rasteve të të miturve në konflikt me ligjin. Kjo ka ndodhur kryesisht si pasojë e vështirësive ekonomike në familje, përdorimit të pakontrolluar të teknologjisë, bullizmit në shkolla dhe ndikimeve negative nga rrjetet sociale. Për t'u përgjigjur ndaj kësaj situate, Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve I ka dhënë vëmendje të madhe parandalimit dhe fushatave sensibilizuese, që informojnë të miturit dhe të rinjtë mbi pasojat që sjellin sjelljet devijante. Po ashtu, është e domosdoshme që familjet të ndërgjegjësohen për rolin e tyre edukues dhe të forcohen programet mbështetëse për familjet në nevojë. Gjithashtu, duhet të forcohen mekanizmat e kontrollit për përdorimin e teknologjisë nga të miturit. Prindërit duhet të jenë të informuar mbi risqet që mund të sjellë përdorimi i rrjeteve sociale dhe aplikacioneve të ndryshme, dhe të krijojnë një dialog të hapur me fëmijët e tyre për të siguruar që ata përdorin teknologjinë në mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme. Po ashtu, është e rëndësishme që shkollat dhe institucionet arsimore të zhvillojnë programe edukative për përdorimin e sigurt të internetit dhe për ndihmën që mund të ofrojnë në rastet kur të miturit përballen me situata të rrezikshme online.<br>7. Cili është bashkëpunimi juaj me Institutin e të Miturve në Kavajë dhe cilat mendoni se janë elementet që duhen përmirësuar në këtë bashkëpunim, apo tek vetë Instituti për rehabilitimin sa më efiçent e të miturve të përfshirë në krime?<br>Sipas përcaktimeve të germës "a", të pikës II të VKM-së nr. 314, datë 15.05.2019, "Për organizimin, funksionimin si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve", përcaktohet se QPKMR bashkëpunon me Shërbimin e Provës dhe/ose me administratën e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur në:<br>i) përgatitjen e dokumentit për lirimin me kusht, vlerësimin e rrezikut familjar dhe shoqëror/mjedisor dhe të nevojave të të miturit jashtë IEVP-së;<br>ii) përgatitjen e planit individual të rishoqërizimit dhe të rehabilitimit, sipas programeve të shërbimeve;<br>iii) përgatitjen e planit të menaxhimit të riskut, në rast të identifikimit të rrezikut të mesëm apo të lartë për recidivizëm;<br>iv) ndjekjen, mbikëqyrjen dhe ofrimin e mbështetjes psikologjike, arsimore, shëndetësore dhe situatën sociale të të miturit pas dënimit; | E plotë | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | 7.11.2025 | Une jam Marisa Harri. Kam mbaruar studimet 3+2 ne Fakultetin e drejtesise , UT.<br>Kam mbaruar master shkencor me drejtim Penal dhe Kriminologji.<br>Kam mbrojtur teme diplome mbi viktimen dhe trashegimetaret e saj.<br>Doja te dija nese ju keni ndonje vend vakant per mua pasi me pelqen shume te angazhohem dhe te jem pjese e kesaj Qendre per parandalimin e krimeve te te Mitureve.<br>Kam mbaruar me rezultatet relativisht shume te mira.<br>Pervec kesaj po ndjek online dhe ne La Sapienza ne degen e Global Humanities studime!<br>Ne pritje te pergjigjes suaj, | 12.11.2025 | Pershendetje,<br>Duke ju  falenderuar per interesimin tuaj, ju bejme me dije se institucioni jone nuk ka vende vakante dhe punesimi kryhet nepermjet Departamentit te Administrates Civile. | E plotë | Jo |